



BASHKIA FIER

Adresa: L. "Kastriot"; Rruga "Ramiz Aranitasi"; Nr.15 Fier - SHQIPËRI Tel. + 355 34 410 650 website:bashkiafier.gov.al

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I RRUGES DULLAS – GRECALLI – MUJALLI

TE PERGJITHESHME

Ne zbatim te Projekt detyres eshte kerkuar hartimi I projektit te zbatimit per Rikonstruksionin e Rruges Dullas – Grecalli – Mujalli me nje gjatesi prej 4272m .

Kjo rruge shtrihet ne pjesen Verjore te Njesise administrative Qender Fier dhe ben lidhjen e te tre fshatrave me qytetin e Fierit dhe me Njesine administrative te Komunes .

Drejtoria e projektimit prane Bashkise Fier hartoi kete material per kete projekt zbatimi :

1. Pershkrimi I gjendjes aktuale
2. Masat qe do te merren per ndertimin dhe rikonstruksionin e rruges .
3. Masat inxhinjerike .
4. Vizatimet me hollesite e domosdoshme.

1.PERSHKRIMI I PROJEKTIT:

GJENDJA DHE MASAT QE DO MERREN PER RIKONSTRUKSIONIN: Rikonstruksioni I Rruges Daullas – Grecalli – Mujalli eshte hartuar ne baze te projekt detyres se miratuar .

Ne zbatim te projekt-detyres eshte bere realizimi i projektit, ku ne te jane pasqyruar hollesisht te tere elementet e domosdoshem per rikonstruksionin e saj. Rikonstruksioni i rruges perfshin segmentin rrugor i cili kalon ne qendrat e fshatrave ku ne vitet e para qendrat e tyre kane filluar te bejne ndertimin e rrugeve por jane lene pa perfunduar . Keshtu Qendra e fshatit Daullas eshte lene pa perfunduar edhe 102 ml, e cila eshte parashikuar ne kete projekte ne vazhdimesi te rruges se ndertuar nga Fondi Shqiptare i Zhvillimit.nga piketa Nr.0 deri ne Piketen Nr.4 me gjersi kaluse 5 metra me dy kuneta ne te dy anet (2 x 50 cm) dhe me trotuare ne te dy krahet me gjersi 2 x 2 m .Ne realizimin dhe rikonstruksionin e rruges eshte bere me trotuare mbasi te tre fshaterat kane nje shkollë te perbashket dhe rruga ne dy fshaterat(Daullas e Grecalli) eshte pare si rruge urbane me trotuare . Ne vazhdim drejte shkolles se

perbashket e cila eshte midis fshatit Greçalli dhe Daullas , ku eshte punuar edhe ne vitet e meparshme , nga greçallia ne drejtim te shkolles rruga eshte bere me gjersi 6 metra me kuneta 2x50 cm dhe me trotuare nga te dy krahet 2 x 2 m , ka gjatesi prej 407 metra. Qe nga Daullasi ku perfunduar qendren e deri ke shkolla , ky segment perfshihet nga piketa Nr.04 deri ne piketen Nr.19. Para shkolles duke qene se mundesite jane, eshte realizuar me nje gjatesi prej 90 m nga piketa Nr.19 deri ne piketen Nr.23 nje zgjerim rruge per qendrim dhe parkim mjetesh per personelin e shkolles me nje gjersi 10.5 m me kuneta 2 x 50 cm dhe me trotuare ne te dy krahet (3.2+1.5)m .

Qe nga shkolla e deri ne kryqezimin e pare drejt fshatit Greçalli nga piketa Nr.23 deri ne pik.Nr.37 ky segmenti i rruges ka nje gjatesi prej 386 m dhe eshte parashikuar rikonstruksioni i saj me nje gjersi 5 m me dy kuneta (2x50 cm) dhe me trotuare ne te dy krahet (1.5+2.5 m).Nga piketa Nr.37 deri ne kryqezimin e pare qe del nga fshati Greçalli ne pik.Nr.58 me nje gjatesi prej 519 m me nje gjersi prej 6m dhe me kuneta 2x50 cm ku ne lindje te saj jane pusetat e kolektorit te ujrave te zeza parashikuar ulja e tyre ,mbasi kjo rruge e ndertuar sic u permend me larte ka hasur ne veshtersine e levizjes se shtyllave elektrike , per kete arsye jemi detyruar qe shtyllat te mos i levizim por gjersojme 1 m trotuarin , hollesishte eshte paraqitur ne projekt .Po nga pik.Nr.58 deri ne piketen Nr.60 eshte parashikuar ngushtimi i rruges nga 6 m ne 5 m me kuneta 2x50 cm dhe me trotuare ne te dy krahet (1.5+2m).me nje gjatesi 44 m.Ne kete segment kemi edhe ndryshimin e aksit prej 0.5m dhe konkretishte ne pik.Nr.58.

Ne Perfundimin e qendres se fshatit Greçalli dhe ne vazdimesi deri ne fshatin Mujalli dhe konkretishte ne piketen Nr.60 sipas projekt detyres eshte parashikuar nje gjersi rruge prej 5 m dhe ne te dy krahet jane parashikuar ndertimi i bankinave me nje prej 0.7 meter dhe me kanale ansore .Nga piketa Nr.60 deri ne kthesen e pare 90 gradshe majtas segmenti ka nje gjatesi prej prej 485 m .Nga piketa Nr.78 deri ne piketen Nr.93 ka nje gjatesi prej 436 m dhe rikonstruksioni eshte parashikuar me nje gjersi kaluse 5 m me bakina ne te dy krahet 2 x 70 cm dhe me kanale kullimi .

Gjate gjithë gjatesise se rruges nga piketa Nr.94 deri ne pik.Nr.151+1.8m ne hyrje te fshatit Mujalli ka nje gjatesi prej 1686m dhe realizuar me nje gjersi prj 5 m dhe me bankina ne te dy krahet 2x0.7 m si dhe me kanale ne te dy krahet .

Nga piketa Nr.151+18m deri ne perfundimin e saj Piketa Nr.155+3m me nje gatesi prej 96.2m +52 m perpendikular me aksin eshte parashikuar ndertimi i saj me gjersi 5m me bankina 2x50 cm dhe me trotuare ne te dy krahet nga (0-2) m + (0-2) m..

Ne rikonstruksionin e rruges eshte parashikuar zgjerimi i saj ne te dy krahet duke arritur gjersit percaktuse sipas profileve terthore tip,ku jane parashikuar germimet dhe ndertimet e themelit te rruges kurse ne gjeresine prej 3.5 m e cila aktualishte eshte me rere bituminoze dhe teper e gropezuar eshte parashikuar heqja e saj Skarifikimi dhe hedhja e nje shtrese stabilizanti ne uniformitet me zgjerimin t=10 cm si dhe 7 cm jane shtresat asfaltike (binder+ Asfalto Beton).

Nga piketa Nr 60 deri ne piketen Nr.155+3m largimi i ujrave eshte parashikuar nga te dyja anet e rruges nepermjet kanaleve ekzistues te cilet do te pastrohen, germohen .Ne kete segmente jane dy kthesa 90 gradeshe te cilat u eshte bere zgjerimi i

pershtateshem ne te dyja anet sipas projektit ku jepen hollesishte te dhenat e ndertimit te tyre dhe te zgjerimit .Po keshtu ne keto kthesa eshte parashikuar edhe vendosja e barjerave metalike (Guard real H/2).

Ne piketen Nr.92 eshte parashikuar edhe ndertimi i nje tombinoje $\Phi = 1000$ mm per largimin e ujrave nga krahu i Djathte per ne krahun e majte ku eshte edhe kolektori i ujrave kulluse.

Per realizimin e ketij projekti do te jete e nevojshme skarifikimi i rruges ne nje thellesi jo me pak se 50 cm ku eshte zgjerimi dhe atje ku eshte e nevojshme sipas profileve dhe projektit eshte parashikuar dhe mbushje me material shkembor ose cakull mbeturine .Ne pjesen ku do te behet skarifikimi dhe heqja e reres bitumonoze do te karikohet me stabilizante .

Ne piketat Nr.73 dhe midis piketes 68-69 jane parashikuar ndertime tombinosh ose kalime ansore sipas projektit .

Ne degezimet dytesore do te rikonstruktohen sipas te dhenave ne projekt me gjerisin aktuale sipas profilit tip te paraqitur me emertimin kalimet ansore.

Shtresat e parashikuara ne rikohstruksionin e rruges do te jene sipas profileve tip te dhena ne flete te vecanta te projektit dhe konkretishte do te jene :

- 1.Shtres cakulli minash 0-100 mm t=15 cm
- 2.Shtres cakulli 0- 80. mm t=15 cm
- 3.Shtres stabilizanti (0-20)mm..... 1x10 cm

Shtresat asfaltike gjate gjithe gjersise se rruges jane parashikuar dhe paraqitur sipas prerjes terthore tip si me poshte :

- 1.Shtres binderi 3 cm
- 2.Shtres asfalto betoni 1x4 cm .

Kunetat ansore jane parashikuar te behen me beton M-200 me gjeresi 50 cm dhe trashesi mesatare 17 cm. Ku gjate zbatimit do te lihen fugat e temperatures cdo dy metra.

Rikonstruksioni i rruges eshte parashikuar me pjerresi te dy aneshme 2.5 % sipas profilit tip te paraqitur ne projekt .

Aksi i rruges do te jete vazhdim i aksit te rruges ne qender Daullas nga piketa 0-4 dhe ne vazdim 2.5 metra nga Bordura e krahut te djathte te rruges ne qender Daullas .

KANALIZIMET

Ne projekt eshte parashikuar qe te ndertohet largimi i ujrave te bardha nga piketa Nr.0 deri ne pik.Nr.60 duke bere kalimin me tubo te brinjezuar $\Phi =250$ mm SN8 dhe me puseta me sinfon 50x80 cm te vendosura ne kunet te cilat bejne grumbullimin dhe derdhjen e tyre ne pusetat e bera te kolektorit te ujrave te zeza.

Ne Preventive eshte parashikuar edhe ulja (prerja) ose ngritja e pusetave per te bere te mundur rakordimin me kuotat me te cilen do te realizohet rikonstrukcioni i rruges .Vendi i pusetave ne projekt mund te ndryshoje gjate zbatimit duke ju pershtatur sa me mire realitetit me miratimin e supervizorit. Pusetat qe jane parashikuar ne projekt jane te tipit "Tsh2" ku sinfonin e kane ne vetvete.

Gjate zbatimit te punimeve mund te shkaktohen demtime ne rrjetin e ujsjellsit prandaj riparimi i tyre do te behet sipas asistences teknike te Ujsjellsit.

TROTUARET

Nga te dy krahet e rruges do te ndertohen trotuaret me gjersi te cilat i pershkruam me larte nga piketa Nr.0 deri ne Pikete Nr.60.Ne ndertimin e trotuarit eshte parashikuar ne projekt me nje shtresa cakulli ose zhavorr prej 10 cm dhe mbi te nje shtres asfaltobetoni Ranor me trashesi $t=3$ cm .Ne perfundimet ansore te trotuareve eshte parashikuar ndertimi i nje bordure 10 x30 cm me beton monolit ose bordura parafabrikat.

Eshte parashikuar ngritja e pusetave ekzistuese te cilat do te demtohen gjate ndertimit te tij .Gjate zbatimit te punimeve duhet patur kujdes ne lidhjen e te gjitha demtimeve te lidhjeve terthore te qytetareve , si te ujit te pijshem dhe te kanalizimeve te K.U.Z.

SINJALISTIKA

Ne projekt-preventiv pervec hollesive te lart permendura eshte parashikuar te behet edhe ndertimi i sinjalistikes , vendosja e tabelave , te drejten e kalimeve , vijezimet si per kembesore ashtu edhe per mjete . Ne realizimin e sinjalistikes horizontale duhet te keni parasysh perdorimin e bojes Fosforishente e aplikuar me dimeione : per vijezim kalimtaresh 0.5 x 3 m me hapsira boshe 0.2 m ,per vijezim makinash dhe karexhate me dimeione 0.2 m gjeresi.Para kthesave 6m vendoset viza ndaluese paralajmeruese.

Ne realizimin e sinjalistikes vertikale ne projekt jane parashikuar tabelat me diameter 0.6 m dhe lartesi 2.5 m brenda standarteve qe parashikon kodi rrugor (fosforishente).Inkastrimi i tabelave (tubos) do te behet me beton dhe jo me pak se 50 cm ku tubua do te jete xingato me diameter Φ 60 mm.

Rruga eshte parashikuar me materiale standarte sipas KTZ.

3 MASAT INXHINJERIKE

Duke qene se Rikonstrukcion I Rruges Ne Fshatrat Daullas – Greçalli – Mujalli hyn ne rruge Urbane ku ben lidhjen e te tre fshatrave me qytetin e Fierit dhe te Komunes Qender. Per kete qellim gjersia aktuale e rruges nuk eshte cenuar por eshte lene .

Nepermjet pjerresise terthore prej 2-2.5 % eshte bere e mundur largimi i ujrave te shiut te cilat nepermjet pusetave te vendosura ne kuneta nga piketa Nr. 0-60 dhe te kanaleve ansore nga piketa Nr.60 deri ne piketen Nr.93 bene qe jetgjatesia e rruges te jet e madhe .

Per zbatimin e ndertimit te rruge ne vende te vecanta jane lene pika fikse si per aksin e rruges ashtu edhe per kueten e projektit ,vecanrishte ne lidhjen e rruges qe po bejme me rrugen egzistuese , ku bashkimi i saj dote behet duke bere prerje me sharre dhe me ne zbutje shume te embel.

Fillimi i rruges do te behet sipas percaktimit ne planimetri te pikave dhe kuotave fikse

REKOMANDIME

Duke respektuar nderhyrjet per themelin e rruges ,permirsimet e elementeve gjeometrik dhe tegjitha punimet qe do te kryhen per rikonstrukcionin e rruges Organizimi i pune mendojme te behet ne kete menyre :

1.Ne fillim puna do te filloj ne ndertimin e tombinos, Kalimeve ansore dhe te zgjerimeve gjate githe gjatesise ku eshte e percaktuar ne projekt.

2.Ndertimin e kanalizimeve te ujrave te bardha dhe ne vazhdim ne zgjrimin e kthesave , ndertimin e zgjerimit ne te dy krahet e rruges duke hedhur vetem shtrese e pare te cakullit te minave $T=15$ cm , duke e bere bllokimin e rruges , perfundimin e skarifikimit te rruges ekzistuse dhe pastaj shtrimin e saj sipas pershkrimit te shtresave si me larte dhe duke respektuar KTZ dhe projektin.

PROJEKTUESI

Ing. Haxhi AVDULLAI

Ing.Mariola VELAJ

Procurement
Albania

TE DHENA TEKNIKE

A. PUNIME RRUGORE

1. GERMIM DHEU KASONET ME MAKINERI

Ky ze pune eshte parashikuar ne zgjerimin e rruges dhe te kryhet me makineri dhe te ngarkohet ne AUTO . hidht ne vendet e percaktuara me pare nga investitori . Pjesa fundore nivelohet e profilohet ,si dhe rulohet me rul. Matet ne m³.

2. PRISHJE SHITESASH NE RRUGE(skarifikimi)

Prishja e shtresave ne rruge eshte parashikur te kryhet me makineri ne trashesine duke hequr vetem shtresat e reres bituminoze .Matja do te behet ne m².

3. SHITRESE CAKULL MINASH 0-100 dhe 0-80 mm.

Ky material do te perbehet nga cakull minash gur I thyer dhe I perzier ne granulometrine e duhur , shtresa do te behet t=15 cm .Ngjeshja do te behet me rula vibrues duke e lagur me uje dhe do te jete 95%.Ne analize parashikohet blerja , transporti , perhapja dhe ngjeshja e shtreses .Matja do te jete ne m². Materialet e perdorura per shtresen baze te perbere prej gureve te thermuar do te merren nga burimet e caktuara gurore , duhet te jene te forte me durueshmeri te mire. Nuk duhet te permbaje pjese shkembinjesh te dekompozuar ose material argjilor.

4.SHITRESE MATERIAL I THYER 0-40mm.

Ky material do te perbehet nga cakull frantoreje gur I thyer dhe I perzier ne granulometrine e duhur , shtresa do te behet 1 x 15 cm .Ngjeshja do te behet me rula vibrues duke e lagur me uje dhe do te jete 95%.Ne analize parashikohet blerja , transporti , perhapja dhe ngjeshja e shtreses .Matja do te jete ne m².

Materialet e perdorura per shtresen e lartpermendur jane te perbera prej gureve te thermuar , do te merren nga burimet e caktuara gurore ,duhet te jene te forta dhe me durueshmeri te mire.Nuk duhet te permbaje pjese shkembinjesh te dekompozuar ose material argjilor.

5.SHITRESE MATERIAL I THYER 0-20 mm.(stabilizant)

Ky material do te perbehet nga cakull frantoreje gur I thyer dhe I perzier ne granulometrine e duhur , shtresa do te behet 1x 10 cm .Ngjeshja do te behet

me rula vibrues duke e lagur me uje. Ne analize parashikohet blerja transporti ,perhapja dhe ngjeshja e shtreses .Matja do te jete ne m².

Materialet e perdorura per shtresen e lartpermendur jane te perbera prej gureve te thermuar do te merren nga burimet e caktuara gurore ,duhet te jene te forta dhe me durueshmeri te mire.Nuk duhet te permbaje pjese shkembinjesh te dekompozuar ose material argjilor.

Materiali I thermuar duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme :

a-Vleren e copetimit te agregateve.

Coptezimi I agregateve nuk duhet te kaloje 29% te firos.

b-Indeksi I plasticitetit

c-Kerkesat per ndarje (shkallezim)

Ne vendet me densitet te matur ne gjendje te thate te shtreses se ngjeshur , vlera minimale duhet te jete 98 % e vleres se proktorit te modifikuar.

6.PROFILIM ME STABILIZANT

Ne kete ze eshte parashikuar pastrimi I siperfaqes ekzistuse,shtrimi dhe nivelimi me grejder I shtreses se stabilizantit 10 cm vecanrishte ne rruget ekzistuse te cilave ju jane hequr shtresat asfaltike .Stabilizanti perbehet me material te thyer guri sipas stadarteve te miratuar.Matja eshte ne m².

7.SHTRESE BINDERI 4 CM

Ne kete ze eshte parashikuar pastrimi I siperfaqes qe zgjerohet , sperkatja me emulision bituminoz nga 0.8 – 1.2 liter/m² , si dhe prodhimin ose blerjen , trasportin dhe shtrimin e binderit me makineri (rul) . Shtresa e binderit do te jete 4 cm mbas ngjeshjes . Prodhimi I binderit do te behet me material te thyer guri sipas stadarteve te miratuar.Matja eshte ne m².

8.SHTRESE ASFALTO – BETONI

Ne kete shtrese eshte parashikuar sperkatja e te gjithe siperfaqes ekzistuse dhe zgjerimit me bitum 0.51 litra /m² , prodhimin ose blerja , transportasi , shtrimi I asfaltit me makineri (rul).Shtresa do te jete 3 cm.

Asfalto betoni qe do te perdoret duhet te prodhohet nga materiali I thyer guri 0 – 10 mm , sipas stadarteve te miratuar.

Toleranca ne ndertim : Kontrolli do te behet cdo 25 metra dhe do te jete

Gabim ne gjeresi 2 cm

Gabim ne lartesi 1 cm

Ne kete ze pune eshte parashikuar edhe ngjeshja me rul sipas K.T. Z.

9.KUNETA

Kuneta do te ndertohet sic eshte parashikuar ne projekt sipas K.T.Z.Betoni dote jete M-200 dhe trashesia e saj do te jete mesatarishte 17 cm .

Matja eshte me m³ ,

10.SHTRESE BETONI M-100 (nen bordure)

Kjo shtrese parashikon marrjen,blerjen , transportin si dhe nivelimin e betonit M 100 , t=10 cm nen bordure. Matja do te jete ne m³.

11.F.V. BORDURA 20x35x100 M 200 TE PARAPERGATITURA

Ketu eshte parashikuar blerja, transporti dhe vendosja e tyre ne rruge. Bordurat do te jene prej betoni M 200 te parapergatitura dhe me permasat e percaktuara ne projekt. Matja do te jete ne ml.

12.TOMBINO BETONI ME GOTE Ø1000 mm

Ky ze pune parashikon F.V te tubove te betonit te parapregatitur Ø 1000 mm, me gote, te vendosur mbi shtrese betoni 20 cm te klases C16/20 dhe te bashkuara me llacimento ne raport 1:2. Ne hyrje dhe dalje te tombinos jane parashikuar vendosja e ballandave te cilat do te realizohen me beton te klases C16/20. Matja eshte ne ml.

B. PUNIME KANALIZIMI

1. GERMIM DHEU ME KRAH.

Germimi i dheut eshte parashikuar pas skarifikimit te rruge, ne hapjen e KUB dhe pusetave qe do te kryhen me krahe dhe do te largohen me auto,Pervec nje pjese te vogel qe do te perdoret per mbushje. Matja ne m³.

2. F.V. TUBO P.V.C Ø=250 MM TE BRINJEUAR,

Eshte parashikuar F.v. e tubove P.V.C. **Ø250 mm** te brinjezuar, ne te gjitha kanalizimet e ujrave te shiut te cilat do te kryhen sipas kushteve teknike dhe projektit. Materiali duhet te pajiset me certifikaten e cilesise. Matjet ne ml.

3. F.V. TUBO B/ARME $\Phi=600$; TUBO BETONI $\Phi=400$,

Eshte parashikuar F.v. e tubove b/arme me diameter 600 mm me gote dhe tubove betoni me diameter 400 mm me gote, ne te gjithe Kalimet ansore , te cilat do te kryhen sipas kushteve teknike dhe projektit. Materiali duhet te pajiset me certifikaten e cilesise. Matjet ne ml.

4. NGRITJE PUSHTASH

Pusetat jane te ndertuara Ky ze pune parashikon vetem ngritjen ose uljen duke i pershtatur me kuotat e projektit te rruges dhe trotuarit ,ne te gjitha pushtave ekzistuese ne rruge dhe ne trotuar pasi kapaket ato i kane. Matja ne cope.Mund qe te zvendesohet pjesa konike duke ruajtur ato qe jane gjendje prane investitorit.

5. PUSHTA SHIMBLEDHESHE

Ky ze pune parashikon ndertimin e plote te pushtave te shimbledhesave dhe vendosjen e kapakeve te gizes sipas vizatimeve ne projekt tipi "Tsh2". Matja ne cope.Ne kete cmim eshte perfshire germimi, shtresa e betonit,betoni i pushtes dhe vendosja e kapakut te gizes me mentesha .

6. SHITRESE RERE NEN TUBO

Ne kete ze pune eshte parashikuar qe nen tubot e ujrave te bardha te shtrohet nje shtrese rere 10cm . Matja do te jete ne m3.

7. MBUSHJE ME ZHAVORR

Ky ze pune parashikon marrjen, transportin dhe mbushjen e kanalit me zhavorr duke e ngjeshur me shtresa deri ne 20 cm. Mbushja me zhavorr eshte parashikuar deri ne kuoten e kasonetes.

8. TRANSPORT I DHEUT DHE MBETURINAVE

Ne kete ze pune parashikohen largimi i dherave dhe mbeturinave qe do te dalin nga germimimet qe do te dalin i kasonetes dhe kanalit ne distancen 5 km.

C. PUNIME TROTUARI

1. SHTRESE ZHAVORRI 10 cm

Kjo shtrese parashikon marrjen, transportin si dhe nivelimin e zhavorrit ne trotuar t=10 cm. Matja do te jete ne m².

2. F.V. BORDURA TROTUARI MONOLITE BETON M 200 -10X30

Ketu eshte parashikuar blerja, transporti dhe vendosja e tyre ne rruge. Bordurat do te jene beton monolite M 200 dhe te permasave te percaktuara ne projekt. Matja do te jete ne ml ose m³.

Te gjitha prishjet e domosdoshme dhe trasporti i mbeturinave jane parashikuar ne preventiv.

Per cdo paqartesi do te merret kontakt me grupin e projektimit

3. TROTUAR ME ASFALTOBETON t=3 cm

Ky ze pune parashikon ndertimin trotuareve me asfaltobeton me t=3 cm, mbi shtrese cakulli 10 cm. Matja me m².

PROJEKTUESI

Ing.Haxhi AVDULLAI

Ing.Mariola VELAJ